



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3.4.2023

Nr: 253

Ora: 17:00

VENDIM
PËR
PËRDORIMIN ZYRTAR TË NDËRPLATFORMAVE TË KOMUNIKIMIT ME ADMINISTRATËN
ZGJEDHORE

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh” e “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

- I. Përdorimi i ndërplatformave të komunikimit.
 1. Komunikimi ndërmjet KQZ-së dhe administratës së KZAZ-ve, KQV-ve, GNV-ve dhe personelit teknik të kontraktuar për shërbime zgjedhore, për shkëmbimin e mesazheve dhe thirrjeve, realizohet nëpërmjet ndërplatformave WhatsApp, Telegram e të ngjashme me to.
 2. Ndërplatformat shërbejnë për të informuar administratën e nivelit të dytë dhe të tretë në lidhje me udhëzimet më të fundit të KQZ-së, kujtesa për detyrat dhe komunikime të tjera, me qëllim bashkërendimin e procesit zgjedhor.
 3. KQZ vendos në dispozicion të administratës zgjedhore linja ndihme telefonike pa pagesë, si dhe kanale komunikimi në ndërplatformat e komunikimit të telefonisë celulare.
 4. KQZ krijon llogari zyrtare në emër të saj në ndërplatformat e komunikimit nën kontrollin e autoriteteve kompetente publike të Republikës së Shqipërisë (0800), nën kontrollin e KQZ-së (aplikacione të posaçme) apo edhe në platforma të pakontrolluara nga KQZ (WhatsApp, Telegram, etj.).
 5. Llogaritë krijohen duke ndjekur këtë procedurë:
 - a) Sekretari i Përgjithshëm në koordinim me drejtoritë që kanë aktivitet me administratën zgjedhore dhe personelin teknik të kontraktuar për shërbime zgjedhore, koordinon aktivitetet për krijimin e llogarive dhe kanaleve të komunikimit me KQZ-në.
 - b) Drejtoritë apo strukturat e KQZ-së administrojnë komunitetet/grupet e përdoruesve, shtojnë ose largojnë përdoruesit e jashtëm të administratës zgjedhore, gjenerojnë ftesat e komunikimit për administratën zgjedhore në format lidhje ose QR Code.

Data: 3.4.2023 Nr.253
Ora: 17:00



“Për përdorimin zyrtar të ndërplatformave të komunikimit me administratën zgjedhore”

- c) Administrata e KQZ-së administron numeracionin telefonik të administratës zgjedhore dhe krijon/fton përdoruesit të bëhen pjesë e ndërplatformave nga llogaritë e tyre individuale.
6. Komunitetet/grupet e përdoruesve krijohen të dedikuar për çdo nivel të administratës zgjedhore dhe identifikohen online me logon më të fundit të KQZ-së.
7. Për çdo komunitet/grup të krijuar, administratori do të jetë së paku në nivel drejtori drejtorie. Për përcjelljen e informacionit caktohen një ose disa nëpunës të KQZ-së. Informacioni që i komunikohet komunitetit/grupit të krijuar nga nëpunësi/it e ngarkuar me koordinimin dhe komunikimin me përdoruesit e komuniteteve/grupeve të krijuar, miratohet paraprakisht, nga eprori.
8. Drejtorja e Logjistikës dhe Digjitalizimit krijon akses për transmetim informacioni për përdoruesin e linjës së ndihmës dhe drejtorët e drejtorive që administrojnë këto grupe

II. Keqpërdorimi i informacionit/të dhënave

9. Përdoruesit e komuniteteve/grupeve të komunikimit nuk duhet të keqpërdorin informacionin që administrojnë, nuk duhet ta përdorin për aktivitet politik, dhe nuk duhet ta bëjnë publik apo të shkëmbejnë informacionin që administrohet në këto platforma me median, partitë politike apo palë të tjera që nuk janë administratë zgjedhore.
10. Përdoruesit nuk duhet të transmetojnë/shkëmbejnë të dhënat personale me të cilat ata vihen në posedim/dijeni.
11. Çdo përdorues që nuk është komisioner/anëtar i administratës zgjedhore duhet të largohet menjëherë nga grupi ku i është dhënë mundësia e aksesit.

III. Siguria e të dhënave dhe arkivimi

12. Të dhënat që administrohen në ndërplatformat e komunikimit duhet të jenë të sigurt, të ruajtura dhe të paaksesueshme për t'u edituar nga të tretët.
13. Të dhënat e përdorura eksportohen në format të lexueshëm dhe protokollohen deri në fund të vitit kalendarik.
14. Të dhënat e gjeneruara në ndërplatformat e komunikimit fshihen me përfundimin e verifikimit paszgjedhor.

IV. Hyrja në fuqi

15. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
16. Ngarkohet administrata e KQZ-së, administrata zgjedhore dhe personeli teknik i kontraktuar për shërbime zgjedhore për zbatimin e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI